



Misioni i OSBE-së në Kosovë

Fakte për misionin

2013

HYRJE

Misioni i OSBE-së në Kosovë promovon të drejtat e njeriut dhe sigurinë e të gjithë njerëzve në Kosovë përmes monitorimit dhe mbështetjes së punës së institucioneve lokale. I themeluar në vitin 1999, ky Mision paraqet edhe praninë më të madhe në terren të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

Mandati i Misionit përfshinë promovimin e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë. Për t'i kontribuar zhvillimit të një shoqërie demokratike dhe shumetnike në Kosovë ku mbrohen të drejtat e të gjitha komuniteteve, Misioni fillimisht ka ndihmuar në themelimin dhe zhvillimin e disa institucioneve të nevojshme. Disa nga këto institucione janë: Kuvendi i Kosovës, administratat komunale, Avokati i Popullit, instituti gjyqësor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, transmetuesi publik, rregullatorët e mediave, shkolla e policisë dhe inspektorati policor. Në pajtim me qëndrimin neutral të OSBE-së ndaj statusit, Misioni vazhdon t'i përkrahë këto institucione duke monitoruar punën e tyre për përputhshmëri me standardet e të drejtave të njeriut dhe me parimet e qeverisjes së mirë, si dhe duke ofruar këshilla dhe trajnime për t'i adresuar lëshimet e mundshme.

Përmes stafit të pranishëm në komuna, në Kuvendin e Kosovës dhe në disa institucione publike të pavarura, Misioni promovon respekt të dyanshëm dhe tolerancë ndërmjet komuniteteve, si dhe ndihmon krijimin e një shoqërie të shëndoshë e shumetnike. Rikonfigurimi i Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) e ka rritur rëndësinë e pranisë unike të OSBE-së në terren, posaçërisht në fushën e monitorimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve.

Pas më tepër se dhjetë vitesh punë, Misioni ka krijuar marrëdhënie të mira pune me të gjitha komunitetet dhe institucionet vendore, dhe është një nga partnerët kryesor të komuniteteve, institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare. Ekipe të terrenit dhe njësitë e specializuara të OSBE-së që punojnë në lëmi si prona, qeverisja e mirë, komunitetet, çështjet gjyqësore apo të policisë e informojnë bashkësinë ndërkombëtare rreth zhvillimeve konkrete në këto fusha dhe ndihmojnë në arritjen e rezultateve pozitive.

Aktivitetet

Misioni i OSBE-së është i angazhuar në tri fusha kryesore: të drejtat e njeriut, demokratizim, dhe siguri publike. Misioni punon me institucionet në nivel qendror dhe lokal në Kosovë, si dhe me institucionet e pavarura në secilën prej këtyre fushave. OSBE gjithashtu monitoron punën e institucioneve dhe ofron këshilla se si të përmirësojnë performansën e tyre dhe shërbimet ndaj qytetarëve.



Mbrojtja e të drejtave të njeriut

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Kosovë është një ndër prioritetet kryesore të Misionit. Kjo kërkon një sistem gjyqësor funksional dhe mekanizma efektivë për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Për këtë arsye, Misioni punon me institucionet e Kosovës, përfshirë agjencitë për zbatim të ligjit, për të promovuar përputhshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me parimet e sundimit të ligjit.

Misioni i kushton vëmendje të veçantë të drejtave të komuniteteve, përfshirë këtu kthimin e pronës, kthimin dhe riintegrimin, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, si dhe qasjen në shërbime publike dhe përdorimin e gjuhëve zyrtare. Struktura e misionit në teren me pesë qendra rajonale dhe me mbi 30 ekipe të terenit e bënë OSBE-në të veçantë në këtë aspekt dhe mundëson monitorim dhe raportim efektiv. Për më tepër, ekipet e komuniteteve në rajone shërbejnë si urë në mes të grupeve të ndryshme etnike si dhe ndihmojnë dialogun në mes të komuniteteve dhe institucioneve.

Për të siguruar mbrojtje institucionale dhe të qëndrueshme të të drejtave të njeriut, Misioni i OSBE-së ka ndihmuar themelimin dhe tani mbështet punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili përveç tjerash heton shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut dhe ofron shërbime juridike.

Në përpjekje për të parandaluar shkeljet e të drejtave të njeriut në një fazë të hershme, Misioni e këshillon dhe e mbështet faktorin vendor në shqyrtimin e ligjeve dhe akteve nënligjore për përputhshmëri me të drejtat e njeriut. Këtu përfshihen Komisioni parlamentar për të drejta të njeriut, çështje gjinore, persona të zhdukur dhe peticione, si dhe Komisioni për të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthim.

Misioni është faktor kryesor ndërkombëtar kur bëhet fjalë për monitorimin e gjyqësorit në Kosovë. Për më shumë se dhjetë vite, OSBE ka monitoruar punën e gjykatave penale dhe civile për përputhshmëri me të drejtat e njeriut dhe me të drejtat e komuniteteve. Misioni publikon raporte tematike që përmbajnë rekomandime konkrete se si të përmirësohen procedurat gjyqësore dhe të harmonizohen me standardet ndërkombëtare. Raportet

u shpërndahen sistemit gjyqësor të Kosovës dhe përdoren nga Instituti Gjyqësor i Kosovës, i themeluar nga OSBE, për zhvillimin e trajnimeve të mëtutjeshme për gjyqtarë dhe prokurorë të rinj dhe në detyrë.

Misioni monitoron edhe punën e policisë për përputhshmëri me të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve. Misioni harton raporte për çështje të caktuara të të drejtave të njeriut, si përdorimi i forcës, të drejtat e personave të arrestuar, çështjet e sigurisë që prekin komunitetet, mbrojtja e grupeve të ndjeshme sociale dhe krimet e urrejtjes, të cilat pastaj i dërgohen policisë. Raportet i ndihmojnë policisë në trajtimin e të metave. Misioni po ashtu mbështet zhvillimin e një mekanizmi lokal e të qëndrueshëm për monitorimin e qendrave të paraburgimit për të parandaluar torturën, dhe trajtimet apo ndëshkimet tjera mizore, johumane e degraduese.

Misioni bën përpjekje për të ndihmuar luftën kundër diskriminimit. Në këtë aspekt, Misioni mbështet institucionet e Kosovës në përmirësimin dhe zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit, promovon dialogun ndër-fetar dhe pranimin e diversitetit, si dhe ndihmon organizatat e shoqërisë civile dhe mediave në marrjen e një roli proaktiv për monitorim dhe raportim të çështjeve që lidhen me lirinë e shprehjes dhe gjuhën e urrejtjes.

Misioni gjithashtu punon për të ndihmuar luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore, për të parandaluar dhunën në familje, dhe për të përmirësuar mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave përmes ritjes së bashkëpunimit në mes të gjithë akterëve relevant, përfshirë ministrinë përkatëse, policinë, mbrojtësit e viktimave dhe përgjegjësit e strehimoreve.

Demokratizimi dhe qeverisja e mirë

Ndërtimi i institucioneve dhe zhvillimi i mëtejshëm demokratik mbesin shtyllat kryesore të mandatit të Misionit. Në këtë drejtim, Misioni monitoron punën e institucioneve demokratike, identifikon të metat në punën e tyre, dhe pastaj nxjerr rekomandime ose ndihmon në zbatimin e masave të duhura korigjuese.



Misioni ka ndihmuar Kuvendin e Kosovës që nga themelimi i tij në vitin 2001. Pas periudhës së zhvillimit të kapaciteteve legjislative, Misioni tani fokusohet në ngritjen e aftësive të Kuvendit shkathtësive për të mbikëqyrur degën ekzekutive. Misioni po ashtu ndihmon për të siguruar respektim të rregullave të procedurës në Kuvend dhe se të gjitha organet e Kuvendit, e sidomos Kryesia dhe komisionet, janë funksionale dhe transparente, në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe parimet e qeverisjes së mirë.

Si rezultat i angazhimit të Misionit, Kuvendi ka caktuar afate kohore për pyetje qeverisë, dëgjime publike, hetime dhe debate për politikën. Misioni ka përkrahur komisione të caktuara të Kuvendit në hartimin e planeve vjetore të punës dhe në rishikimin e draft-ligjeve, për t'i harmonizuar me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Misioni punon në fuqizimin e grupeve parlamentare që përfaqësojnë komunitetet jo-shqiptare, dhe promovon përfshirjen e grupeve të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë në procesin legjislativ. OSBE mbështet pjesëmarrjen e grave dhe të rinjve në proceset e vendim-marrjes përmes grupeve joformale të grave dhe të rinjve në Kuvend, si dhe këshillave rinore për veprim në nivel qendror dhe lokal.

Misioni ka ndihmuar themelimin e institucioneve të pavarura, dhe vazhdon t'i mbështesë ato gjatë raportimit para Kuvendit të Kosovës. Këtu institucione përfshijnë Avokatin e Popullit, Bordin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, dhe Komisionin e Pavarur për Media. Misioni i ndihmon këto institucione duke zhvilluar kapaciteteve e tyre operuese dhe duke mbrojtur pavarësinë e tyre nga ndikimet e panevojshme politike.

Prej vitit 2000 deri në 2007, OSBE ka organizuar pesë palë zgjedhje në Kosovë dhe ka themeluar institucionet vendore të zgjedhjeve si Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Sekretariatit e KQZ-së. Misioni u ka ofruar këshilla dhe udhëzime jo-ekzekutive këtyre institucioneve, përfshirë Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe mbështet procesin e reformës zgjedhore. Në maj të vitit 2012, Misioni ka lehtësuar dy runde të votimit për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të Serbisë për personat me të drejtë vote në Kosovë.

Në nivel komunal, Misioni monitoron dhe mbështet punën e institucioneve lokale. Qëllimi është që të përmirësohen shërbimet që u ofrohen të gjitha komuniteteve dhe të lehtësohet reforma e qeverisjes lokale, në pajtim me Kartën Evropiane të vetëqeverisjes lokale. Misioni ndihmon kuvendet komunale dhe komisionet e tyre që të bëjnë mbikëqyrje efektive të ekzekutivit të komunës dhe të përmirësojnë cilësinë e akteve të tyre ligjore. Në përpjekje për të rritur transparencën dhe pjesëmarrjen publike në vendimmarrje, Misioni i mbështet komisionet lokale konsultative, grupet e grave, trupat që përfaqësojnë rininë, dhe nismat e shoqërisë civile, si dhe punon për përfshirjen e tyre në jetën publike.

Misioni promovon shkëmbimin e praktikave më të mira në mes të komunave në fushën e performancës, menaxhimit të resurseve dhe trajtimin e shkeljeve të mundshme e rregullave dhe procedurave administrative nga ana e komunave, si psh. drejtësia administrative. Për më tepër, Misioni vazhdon të shërbejë si forum për dialog të strukturuar në mes të nivelit qendror dhe lokal në një numër fushash të rëndësishme parësore për reformën e qeverisjes lokale.

Misioni ka përkrahur zhvillimin e mediave që nga fillimi. Ka ndihmuar themelimin e transmetuesit publik, Radio Televizionit të Kosovës (RTK); rregullatorëve për mediat elektronike dhe të shkruara, si dhe Institutin Kosovar për Media – një qendër trajnimi për gazetarët në detyrë. Misioni vazhdon t'i përkrah institucionet publike për të siguruar funksionim të pavarur të mediave dhe të rregullatorëve përmes trajnimit të stafit, shqyrtimit të legjislacionit dhe ofrimit të rekomandimeve, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Në fushën e arsimit të lartë, Misioni mbështet universitetet publike në Prishtinë dhe Mitrovicë që të punojnë sipas standardeve evropiane të arsimit të lartë. Misioni ka themeluar Qendrën e Karrierës dhe Qendrës për Mbështetje dhe Fuqizim të Rinisë dhe i mbështet aktivitetet e tyre, siç edhe ka themeluar klubet dhe shoqëritë e studenteve në universitetin në Mitrovicë. Mbështetja që misioni i ka ofruar universitetit në Prizren përqendrohet në arsimimin e mësimdhënësve të ardhshëm dhe në aftësimin e mësimdhënësve në detyrë.



Ruajtja e rendit dhe siguria publike

OSBE luan rol aktiv në forcimin e sektorit të rendit dhe sigurisë publike në Kosovë. Misioni ndihmon në ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strategjive për zbatim të ligjit, përfshirë edhe zbatimin e konceptit të policisë së udhëhequr nga inteligjenca.

Një nga detyrat e para të Misionit të OSBE-së në vitin 1999 ka qenë themelimi i shkollës së policisë e cila do të aftësonte shërbimin e ri shumetnik policor të Kosovës. Me rritjen e kapacitetit trajnues të shkollës, ajo nisi aftësimin e institucioneve tjera të sigurisë publike, si shërbimi korrektues, zjarrfikës, apo të shpëtimit.

Në vitin 2006, shkolla u shndërrua në Qendër për Siguri Publike, Edukim, dhe Zhvillim, dhe që nga viti 2011 në Akademi të Kosovës për Siguri Publike (AKSP). Përgjegjësia menaxheriale u ka kaluar institucioneve lokale në vitin 2008. Megjithatë, Misioni ende ofron trajnime të specializuara për agjencitë për zbatim të ligjit në luftimin e krimit të organizuar, shpëlarjen e parave, trafikimin me qenie njerëzore dhe kontrabandimin e narkotikëve, dhe u ndihmon atyre të përmirësojnë dhe zbatojnë strategjitë e tyre. Misioni po ashtu e mbështet Akademinë për Siguri Publike në definimin e vizionit të saj të zhvillimit dhe të bëhet institucion i certifikuar për arsim të lartë në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe me kriteret e Bolonjës.

Misioni mbështet themelimin dhe punën e Këshillave Lokale për Siguri Publike ku marrin pjesë banorët, policia dhe përfaqësuesit e komunës, për t'i diskutuar dhe trajtuar brengat e tyre të sigurisë dhe për t'i përmirësuar kushtet e jetesës dhe marrëdhëniet ndëretnike. Misioni ndihmon edhe në ngritjen

e vetëdijes në sferën e sigurisë publike përmes aktiviteteve në teren duke filluar nga ligjëratat në shkolla e deri te fushatat e informimit publik.

Duke pasur parasysh se besimi i publikut në punën e policisë ka rëndësi qenësore për stabilitetin në Kosovë, Misioni ka ndihmuar themelimin e Inspektoratit të Policisë, i cili siguron zbatimin e praktikave të qeverisjes së mirë brenda policisë së Kosovës, bën mbikëqyrje të brendshme, dhe heton ankesat kundër policëve. Pas shtatë vitesh mbështetjeje, Inspektorati është bërë tashmë institucion profesional dhe i qëndrueshëm. Kjo është edhe arsyeja pse Misioni e përfundoi mbështetjen e saj të drejtpërdrejte programore për këtë institucion në fund të vitit 2012.

Fakte dhe shifra

Nga data 1 tetor 2012, Shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë është Ambasadori Jean-Claude Schlumberger nga Franca. Misioni ka tri departamente programore: Departamentin për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete, Departamentin për Demokratizim, dhe Departamentin për Siguri dhe Rend Publik. Prania e Misionit në teren numëron pesë qendra rajonale: Gjilanin, Mitrovicën, Pejë, Prishtinën, dhe Prizrenin dhe mbi 30 ekipe të terrenit që mbulojnë të gjitha komunat e Kosovës. Buxheti i Misionit për vitin 2013, është 20,512,840 Euro, dhe numri i të punësuarve përfshinë 603 poste: 166 ndërkombëtarë dhe 437 vendorë. Gati gjysma e stafit punon në teren.

Mandati i Misionit buron nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 dhe Vendimi nr. 305 i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së i datës 1 korrik 1999. Keto dokumente i japin Misionit "rol udhëheqës në çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e institucioneve, demokracisë dhe me të drejtat e njeriut."

Zyra për Informim Publik
OSBE Misioni në Kosovë
Tel.: +381 38 240 100 ext. 1449
press.omik@osce.org

www.osce.org/kosovo

- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) punon për **stabilitet, prosperitet dhe demokraci** përmes dialogut politik për vlerat e përbashkëta dhe përmes punës praktike për rezultate afatgjata.